



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të dispozitave të nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon :

Në bazë të dispozitave të nenit 12 shkronja c) dhe 17 shkronja f) të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 të Ligjit Nr. 04/L– 060 për Mbeturina, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.17 e datës 29.06.2012, Ligjit nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/l-060 për Mbeturina, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 29 e datës 1 Shtator 2022, neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 si dhe nenit 2 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit 15nr.352-47361 të datës 30.09.2020, Kuvendi i Komunës së Lipjanit, në mbledhjen e mbajtur më _____ të miratoj këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E SHTOJCËS A –TARIFAT E SHËRBIMIT TË RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT 15NR.352-47361 TË DATËS 30.09.2020

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet Shtojca A – Tarifat e Shërbimit e cila është pjesë përbërëse (e bashkëngjitur) e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.352-47361 të datës 30.09.2020 dhe riformulohet si vijon:

SHTOJCA A- Tarifat e shërbimit

| <u>Nr.</u> | <u>LLOJET E SHËRBIMIT</u> | <u>Tarifat në euro për muaj</u> |
|------------|---|---------------------------------|
| 1. | <u>Ekonomitë familjare</u> | 6.20 € |
| 2. | <u>Subjektet e biznesit me kontenjerët prej 1.1 m3 me kontenierë të përbashkët</u> | 15.00 € |
| 3. | <u>Subjektet e biznesit me kontenjerët prej 1.1 m3 me kontratë të veçantë për kontenierë të veçantë</u> | 15.00 € për një zbrazje |
| 4. | <u>Për kontenierë prej 7 m3</u> | 50 € për një zbrazje |
| 5. | <u>Për materiale inerte – ndërtim demolimi me kontenjerë prej 7 m3</u> | 115 € për një zbrazje |
| 6. | <u>Institucionet publike dhe Institucionet tjera për llojin e shërbimit me kontenjerë 1.1 m3</u> | 15.50 € për një zbrazje |
| 7. | <u>Institucionet publike dhe Institucionet tjera për llojin e shërbimit me kontenjerë 7 m3</u> | 50.00 € për një zbrazje |

Neni 2 Zbatimi

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtorati për Inspeksion, Ndërmarrja Publike dhe Operatori Ekonomik i përzgjedhur për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave .

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hynë në fuqi 7 ditë publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza juridike për të miratuar këtë Propozim Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 shkronja c) dhe 17 shkronja f) të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 të Ligjit Nr. 04/L– 060 për Mbeturina, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.17 e datës 29.06.201, Ligjit nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/l-060 për Mbeturina, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 29 e datës 1

Shtator 2022, neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 dhe nenit 2 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit 15nr.352-47361 të datës 30.09.2020. Nga të cekurat më lartë, kërkohet nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

INr. 352/01-14083

Lipjan, më 26.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS

IMRI AHMETI

